



## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së gjashtë të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, mbajtur më 4.9.2023, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Pëllumb Bajçinovci, kryesues i Kuvendit, (LDK), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Ajet Brajshori (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Milazim Vitija (LDK), Sami Salihu (LDK), Amir Simnica (LDK), Driton Rukiqi (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Lindita Rexhepi (LDK), Donjeta Dragusha (LDK), Elmire Nikçi-Rexha (LDK), Fiknete Bejtë (LDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Agron Canolli (PDK), Arbnora Ajeti (PDK), Shegë Beqiri (PDK), Fatmir Dervishi, (PDK), Granit Geci (PDK), Liridon Selmani, (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK), Gresa Lahu (PDK), Sami Boroci (AKR), , Endrit Zabërgja (NISMA) dhe Agim Kuleta (LB).

Munguan: Trierë Kasumi-Berisha (LVV), Berat Lahu (LVV), Ermal Osmani (LVV), Feim Osmani (LVV), Gëzim Sveçla (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Arianit Beqiri (LVV), Petrit Reçica (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Faton Zeka (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Violeta Salihu (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Radie Hoxhaj, (LVV), Arbnora Berisha (LVV), Fehmi Kupina (i pavarur), Gëzim Mehmeti (AKR), Berna Saraçi (PDK), Bahri Gashi (AAK), Kushtrim Mushica (AAK), Taulant Maxharraj (AAK), Endrit Gashi (AAK) dhe Valbona Ajeti (AAK).

Të pranishëm ishin edhe: Përparim Rama, kryetar i Komunës, Alban Zogaj, nënkyrytar i Komunës, Vigan Kastrati, drejtor i Drejtorisë së Administratës, Mimoza Sylejmani, drejtore e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Arbëri Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Adelina Sahiti, drejtore e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Granit Rugova, drejtor i Drejtorisë së Sportit, Izet Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Doruntinë Maloku, drejtore e Drejtorisë së Pronës, Plator Gërdovci, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Krenar Xhaferi, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, Valbona Makolli, drejtore e Drejtorisë së Financave, Arben Kçira, përfaqësues nga Zyra ligjore, Osman Bllaca, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve dhe të medieve.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Pëllumb Bajçinovci, kryesues i Kuvendit. Kryesuesi hapi diskutimin rreth pikave të rendit të ditës.

**Mimoza Sylejmani**, drejtore, propozoi që në rend të ditës të futet pika: "Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për groposjen e kafshëve me sëmundje infektive, në fshatin Bërnicë e Epërme, në Prishtinë.

**Alban Zogaj**, nënkyrytar, propozoi që në rendin e ditës të futen pikat:

"Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për Gran Fest – Kosova",

"Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për Prishtina International Film Festival – Prifest" dhe

"Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për Shoqatën për kultivimin e artit skenik "Sythi"".

**Sami Boroci** kërkoi sqarim më të plotë rreth pikave 6, 7 dhe 8 të rendit të ditës, që kanë të bëjnë me pronën komunale, për të cilat tha se kam pak paqartësi. Ai kërkoi që ato të largohen nga rendi i ditës dhe të procedohen në njérën prej seancave të radhës së Kuvendit, kur dhe ndoshta ky Kuvend do ta ketë përbërjen e plotë.

Ai kërkoi të dijë nga ekzekutivi se cila është ideja dhe çfarë efektesh do të prodrojnë këto vendime.

Po ashtu, lidhur me propozimet të cilat u dhanë nga ekzekutivi që të futen në rendin e ditës, mendoj se jemi duke krijuar praktikë të keqe, që në seancë të propozohen pikat e reja të rendit të ditës.

**Doruntinë Maloku**, drejtore, tha se sa i përket pikave 6,7 dhe 8, komisionet kanë dalë me një raport, i cili është prezantuar në një seancë të jashtëzakonshme, është diskutuar gjërë e gjatë, kanë dalë me rekomandime dhe ka qenë si një propozim në seancë, që rekomandimet në raportet e komisioneve të bëhen si propozim-vendime.

**Leutrim Retkoceri** kërkoi të dijë arsyen e futjes si pikë në rendin e ditës "Propozim-vendimi për groposjen e kafshëve", pasi që në KPF u propozua që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës. Po ashtu, kërkoi nga ekzekutivi që të jepet një sqarim më i detajuar rreth propozimit për futjen në rendin e ditës të tri propozim-vendimeve për subvencionimin e festivaleve.

**Kryesuesi** i hodhi në votim propozimet e dhëna, si në vijim:

**Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për, u miratua propozimi që Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për groposjen e kafshëve me sëmundje infektive, në fshatin Bërnicë e Epërme, në Prishtinë", futet në rend të ditës për diskutim.**

Kryesuesi konstatoi se më 17 vota për, 6 kundër dhe 1 abstenim, u miratua propozimi që, "Propozim-vendimin për ndarjen e mjeteve financiare për kultivimin e artit skenik "Sythi", futet në rend të ditës për diskutim.

Kryesuesi konstatoi se më 17 vota për dhe 9 kundër, u miratua propozimi që, "Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për Gran Fest - Kosova", futet në rend të ditës për diskutim.

Kryesuesi konstatoi se më 16 vota për dhe 9 kundër, u miratua propozimi që, "Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për Prishtina International Film Festival – Prifest", futet në rend të ditës për diskutim.

Me propozimet e dhëna, kryesuesi konstatoi se më 24 vota për dhe 2 kundër, u miratua ky

Rendi i ditës:

1. Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të mbledhjeve të jashtëzakonshme dhe mbledhjes së pestë të Kuvendit të Kryeqytetit;
2. Raporti i punës së kryetarit të Kryeqytetit për gjashtëmujorin e parë të vitit 2023;
3. Propozim-vendimi për formimin e komisionit për hartimin e Kodit të etikës, për anëtarët e Kuvendit komunal të Prishtinës;
4. Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Prishtinës për vitin 2022 dhe Plani i veprimit të menaxhmentit;
5. Propozim-vendimi për faljen tatimore për vitin tatimor 2023;
6. Propozim-vendimi për miratimin e raportit, nr. 14.050/01-85379/23, dt. 28.04.2023, të komisionit profesional për verifikimin dhe vlerësimin e kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale;
7. Propozim-vendimi për miratimin e raportit, nr. 14-020/04-0171429/23, dt. 15.04.2023, të komisionit profesional për verifikimin e shfrytëzimit dhe të statusit të banesave në Bregun e Diellit, Fushën e Pajtimit dhe në Hajvali ;
8. Propozim-vendimi për miratimin e raportit nr. 14-050/01-853384/23, dt. 28.04.2023, të komisionit profesional për verifikimin e shfrytëzimit të pronës komunale në zonën industriale;
9. Propozim-vendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit, nr. 01-462/01-134225/23, të dt. 29.06.2023, për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Nazmi (Ruzhdi) Fetahut dhe Magbule (Shahin) Sadrisë;
10. Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Shemsi (Rifat) Begollit;
11. Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të "Alping", SHPK;
12. Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronës të "Delta Invest" SHPK;

13. Projektrregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së organizatave të biznesit në Komunën e Prishtinës, nr. 01. 110-1203, dt. 16.06.2010;
14. Propozim-vendimi për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm "Mati 1", për bllokun A- 11, në Prishtinë;
15. Propozim-vendimi për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm "Prishtina e Re - Zona Perëndim", për pjesën e banimit individual - njësitë hapësinore ILG në Prishtinë;
16. Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për groposjen e kafshëve me sëmundje infektive, në fshatin Bërnicë e Epërme, në Prishtinë;
17. Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për Prishtina International Film Festival - Prifest;
18. Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për Shoqatën për kultivimin e artit skenik "Sythi";
19. Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për Gran Fest - Kosova;
20. Pyetje dhe përgjigje;
21. Të ndryshme.

#### Pika e parë

Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të mbledhjeve të jashtëzakonshme dhe mbledhjes së pestë të Kuvendit të Kryeqytetit.

Kryesuesi konstatoi se më 24 vota për, u miratuan ekstraktet e procesverbaleve të mbledhjeve të jashtëzakonshme dhe mbledhjes së pestë të Kuvendit të Kryeqytetit.

#### Pika e dytë

Raporti i punës së kryetarit të Kryeqytetit për gjashtëmujorin e parë të vitit 2023.

Lidhur me Raportin e punës së kryetarit të Kryeqytetit për gjashtëmujorin e parë të vitit 2023, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Përparim Rama, kryetar, duke thënë se gjatë gjashtëmujorit të parë të këtij viti janë zbatuar një mori projektesh të fushave të ndryshme, e që janë duke u punuar me një dinamikë të madhe. Po ashtu, vlen të veçohet se ne si kryeqytet do ta kemi të drejtën për organizimin e Lojëra Olimpike Mesdhetare 2030, ku do ta kemi edhe përkrahjen e të gjitha organizatave dhe të Komitetit Olimpik, por edhe të Qeverisë, të cilët faktikisht kanë bërë një punë të mrekullueshme deri më tanë.

**Jeta Rafuna - Hasani** theksoi se kryetari Rama edhe një herë po dëshmon transparencën ndaj nesh si asamblistë, si përfaqësues të qytetarëve, duke raportuar punën e kryetarit dhe ekipit të tij për gjashtë muajt e vitit 2023. Në këtë raport shihet se kryetari dhe drejtorët kanë bërë punë të mira në të gjitha dikasteret, si në rregullimin e infrastrukturës rrugore, në qytet dhe në zonat rurale, zgjerimin e rrjetit të ngrohjes dhe shumë projekte të tjera të fushave të ndryshme.

**Fatmir Dervishi** tha se raporti i kryetarit është i përgatitur mirë në vija të përgjithshme dhe i prezantuar mirë nga kryetari, mirëpo besoj se ka nevojë për plotësim. Mendoj se në raport është mirë të përfshihen edhe disa të dhëna më të sakta, të dihet data e fillimit të atyre projekteve etj. Meqë raportimi nga kryetari është gjashtëmujor, do të duhej të përshkruhej edhe fazë gjashtëmujore se cilat punë duhet të kryhen, pra deri në cilën fazë duhet të mbërrijë, e pastaj edhe ditët e realizimit të projektit, që besoj se i ka secili projekt. I falënderoj të gjithë punëtorët e Komunës që kanë kontribuar në kryerjen e punëve shumë të mira, drejtoret, asamblistët dhe të gjithë ata që kanë kontribuar në këtë raport.

### **U konstatua se u përkrah Raporti i punës së kryetarit të Kryeqytetit për gjashtëmujorin e parë të vitit 2023.**

#### **Pika e tretë**

**Propozimvendimi** për formimin e Komisionit për hartimin e kodit të etikës, për anëtarët e Kuvendit komunal të Prishtinës.

**Leutrim Retkoceri** theksoi se për të parandaluar dëmin kolektiv që mund të shkaktojë një individ apo në bashkëpunim me të tjeter, shoqëria njerëzore patjetër duhet të caktojë parime dhe të krijojë vlera të sjelljes se çfarë konsiderohet morale, çka është e mirë e çka është e keqe. Konsideroj se përgjegjësia e asamblistit komunal është e rëndësishme për funksionimin e një qeverisje të drejtë dhe për mirëqenien e komunitetit, kështu që jam për të ndarë një vizion të rëndësishëm, vizionin e themelimit të grupit iniciues për të përpiluar kodin e etikës për Kuvendin komunal të Prishtinës.

Ky është një hap i rëndësishëm në drejtim të ndryshimeve pozitive në komunitetin tonë, në mënyrë që të ndërtojmë një qytet dhe një vend më të mirë dhe më të sigurt për të gjithë. Përmes këtij kodi të etikës, do të ndërtojmë së bashku filtra, që individëve të papërgjegjshëm, me mendje kriminale, t'u pamundësohet të jenë pjesë e këtij tempulli qeverisës të Komunës së Prishtinës.

**Sami Boroci** tha se neve na është prezantuar një pikë e rendit të ditës pa material, andaj kërkoi të dijë se cila është baza ligjore e një Kodit të Etikës për anëtarët e Kuvendit komunal. Nëse dëshirojmë ta shtyjmë përpara një kod të etikës, nëse ka bazë ligjore, mendoj që kjo duhet të ndodhë në një seancë kur përbërja e këtij Kuvendi është e plotë, kështu që tash për tash, nuk shoh të ketë mundësi të krijuhet një kod etik që do të prodhonte efekte juridike. Mendoj që duhet të strukturohet shumë më shumë dhe duhet të shikojmë bazën ligjore fillimisht se ku e ka.

**Vigan Kastrati**, drejtor, u shpreh se jemi duke punuar rrëth themelimit të një komisioni për të punuar në kodin etik, dhe e kemi një projekt, i cili është i shkarkuar prej rekomandimeve të tyre. Thua jse të gjitha komunat veçse e kanë kodin etik, ku në këtë kod përfshihet edhe asambleja, edhe kryetari, edhe të gjithë dhe ky kod do të sillet për votim nga Kuvendi.

**Hafiz Krasniqi** shprehu mendimin se do të ishte mirë që të presim formimin e një komisioni, dhe atëherë kur komisioni paraqitet me një projekt të caktuar, kalojmë në diskutime dhe propozime konkrete.

Faqe5nga10

Në këtë rast, si iniciativë e kisha përkrahur dhe besoj se e përkrahim si Grup parlamentar dhe si bashkëqeverisje.

*Duke pasur parasysh diskutimet nga parafolësit, u konstatua se kjo pikë e rendit të ditës do të diskutohet edhe një herë në njëherë nga seancat e radhiës së Kuvendit.*

#### **Pika e katërt**

**Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Prishtinës për vitin 2022 dhe Plani i veprimit të menaxhmentit.**

Lidhur me Raportin e auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Prishtinës për vitin 2022 dhe Plani i veprimit të menaxhmentit, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Osman Bllaca, drejtor i auditimit.

**Fiknete Bejta**, tha se ne si grup i LDK-së, e kemi analizuar raportin e auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Prishtinës për vitin 2022. Konstatojmë se rapporti tregon përmirësim të performancës financiare dhe këtë e bazojmë në vetë argumentet e prezantuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit përmes këtij rapporti. Opioni i kualifikuar dhe dobësitetë ose çështjet që janë prezantuar në raport si bazë për dhënien e këtij opinioni, tregojnë se Komuna e Prishtinës ka ngritur nivelin e performancës financiare, duke rritur edhe nivelin e kontrollit financier, mirëpo ende ka punë që duhet të bëhen, në mënyrë që të zbatohen rekomandimet e dhëna nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin paraprak.

Jemi të bindur se në realizimin e kontratave kanë ndikuar shumë faktorë, siç kanë qenë bursa ndërkontinentale e rritjes së çmimeve dhe rritja e inflacionit trajtuar globalisht, ka ndikuar që operatorët ekonomikë të shkëpusin shumicën e kontratave për shkak të ngritisës së çmimeve. Mungesa e organit për shqyrtimin e kontratave, ka qenë një prej problemeve krujiale që ka ndikuar në vonesat për realizimin e kontratave në investimet kapitale.

**U konstatua se u përkrah Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Prishtinës për vitin 2022 dhe Plani i veprimit të menaxhmentit.**

#### **Pika e pestë**

**Propozim-vendimi për faljen tatimore për vitin tatimor 2023.**

Lidhur me Propozimvendimin për faljen tatimore për vitin tatimor 2023, Përparim Rama, kryetar, i njoftoi të pranishmit, duke cekur se këtë pikë duhet ta pezullojmë, për arsy se se Gjykata Kushtetuese e ka pezulluar Ligjin për tatim, kështu që ne detyrohem ta kalojmë deri në një vendim meritor të Gjykatës Kushtetuese.

#### **Pika e gjashtë**

**Propozim-vendimi për miratimin e Raportit, nr. 14-050/01-85379/23, dt.28.4.2023, të Komisionit profesional për verifikimin dhe vlerësimin e kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale.**

**Doruntinë Maloku**, drejtore, i njoftoi të pranishmit në pika të shkurtra rreth kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale, duke thënë se të tri këto pika (6, 7, 8) të rendit të ditës, burojnë nga raportet e tri komisioneve profesionale, të cilat janë të themeluara me propozimin e kryetarit Rama, lidhur me verifikimin e shfrytëzimit të pronës komunale të banesave në Bregun e Diellit, Fushën e Pajtimit, në Hajvali, në Zonën industriale dhe verifikimin e të gjitha kontratave të shfrytëzimit të pronës komunale.

**Leutrim Retkoceri**, tha se do të ishte mirë që ta kemi edhe një opinion nga Zyra ligjore se a është ajo pjesa që i hap rrugë fillimit të procesit të verifikimit të pronave komunale, apo ka bazë dhe fuqi vendimmarrëse ky vendim për të zhvilluar procedurën, sepse kjo ka dallim nga ana ligjore dhe për këtë duhet të bëhet më e qartë për anëtarët e Kuvendit. Kjo çështje është diskutuar edhe në të kaluarën dhe është mirë që pronave komunale po u jepet një trajtim që të kthehen në aspektin ligjor, por duhet të dimë këtë çështje, se a do të kthehen për votim prapë, apo do të mbetet derisa Kuvendi të formojë një komision të përhershëm për dhënien e pronës në shfrytëzim.

**Sami Boroci** tha se nëse ne i votojmë këto tri pika, e në veçanti pikën 6, më intereson nga aspekti procedural me shpjeguar si do të vazhdojë procedura derisa të arrihet epilogu final, pra dua të dijë se çka kam me votuar sot.

Lidhur me sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime shtesë dha Doruntinë Maloku, drejtore.

**Kryesuesi konstatoi se më 21 vota për dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për miratimin e raportit, nr. 14-050/01-85379/23, dt. 28.4.2023, të Komisionit profesional për verifikimin dhe vlerësimin e kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale.**

#### **Pika e shtatë**

**Propozim-vendimi për miratimin e Raportit, nr. 14-020/04-0171429/23, dt. 15.4.2023, të komisionit profesional për verifikimin e shfrytëzimit dhe të statusit të banesave në Bregun e Diellit, Fushën e Pajtimit dhe në Hajvali.**

**Kryesuesi konstatoi se më 22 vota për dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për miratimin e raportit, nr. 14-020/04-0171429/23, dt. 15.4.2023, të komisionit profesional për verifikimin e shfrytëzimit dhe të statusit të banesave në Bregun e Diellit, Fushën e Pajtimit dhe në Hajvali.**

#### **Pika e tetë**

**Propozim-vendimi për miratimin e Raportit, nr. 14-050/01-85384/23, dt. 28.4.2023, të Komisionit profesional për verifikimin e shfrytëzimit të pronës komunale në Zonën Industriale.**

**Kryesuesi konstatoi se më 20 vota për dhe 2 abstenime, u miratua Vendimi për miratimin e raportit, nr. 14-050/01-85384/23, dt. 28.4.2023, të Komisionit profesional për verifikimin e shfrytëzimit të pronës komunale në Zonën Industriale.**

#### **Pika e nëntë**

**Propozim-vendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit, nr. 01-462/01-134225/23, të dt. 29.6.2023, për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Nazmi (Ruzhdi) Fetahut dhe Magbule (Shahin) Sadrisë.**

Lidhur me Propozim-vendimin për plotësim-ndryshimin e Vendimit, nr. 01-462/01-134225/23, të dt. 29.6.2023, për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Nazmi (Ruzhdi) Fetahut dhe Magbule (Shahin) Sadrisë, arsyetimin për votimin e këtij propozim-vendimi e paraqiti Doruntinë Maloku, drejtore.

**Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për, u miratua Vendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit, nr. 01-462/01-134225/23, të dt. 29.6.2023, për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Nazmi (Ruzhdi) Fetahut dhe Magbule (Shahin) Sadrisë.**

#### **Pika e dhjetë**

**Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Shemsi (Rifat) Begollit.**

Doruntinë Maloku, drejtore, e paraqiti arsyetimin për votimin e këtij propozim-vendimi.

**Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Shemsi (Rifat) Begollit.**

#### **Pika e njëmbëdhjetë**

**Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të “Alping”, SHPK.**

Doruntinë Maloku, drejtore, e paraqiti arsyeshmërinë për votimin e këtij propozimvendimi.

**Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të “Alping”, SHPK.**

#### **Pika e dymbëdhjetë**

**Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të “Delta Invest”, SHPK.**

Doruntinë Maloku, drejtore, e paraqiti arsyetimin për votimin e këtij propozim-vendimi.

**Kryesuesi konstatoi se më 25 vota për, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të “Delta Invest”, SHPK.**

**Pika e trembëdhjetë**

**Projektrregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së organizatave të biznesit në komunën e Prishtinës, me nr. të protokollit 01/110-1203, dt. 16.6.2010.**

Lidhur me Projektrregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së organizatave të biznesit në komunën e Prishtinës, me nr. të protokollit 01/110-1203, dt. 16.6.2010, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Izet Sadiku, drejtor.

**Kryesuesi konstatoi se më 27 vota për, u miratua Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së organizatave të biznesit në komunën e Prishtinës, e shënuar me nr. të protokollit 01/110-1203, dt. 16.6.2010.**

**Pika e katërmëbëdhjetë**

**Propozimvendimi për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm "Mati 1", për bllokun "A-11" në Prishtinë.**

**Mimoza Sylejmani**, drejtore, e paraqiti arsyetimin për votimin e këtij propozim-vendimi.

**Sami Boroci** tha se kur kemi raste të tilla për revidim të planeve, në këtë rast për shkollë, është komplekt e pranueshme edhe për neve të votojmë, mirëpo kur ka arsyë të tjera nuk do t'i votojmë derisa të miratohen Plani zhvillimor komunal dhe Hartat zonale.

**Kryesuesi konstatoi se më 27 vota për, u miratua Vendimi për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm "Mati 1", për bllokun "A-11", në Prishtinë.**

**Pika e pesëmbëdhjetë**

**Propozimvendimi për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm "Prishtina e Re-Zona Perëndim", për pjesën e banimit individual - njësitë hapësinore "I, L, G", në Prishtinë.**

**Mimoza Sylejmani**, drejtore, e paraqiti arsyeshmërinë për votimin e këtij propozim-vendimi.

**Kryesuesi konstatoi se më 27 vota për, u miratua Vendimi për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm "Prishtina e Re-Zona Perëndim", për pjesën e banimit individual - njësitë hapësinore "I, L, G" në Prishtinë.**

**Pika e gjashtëmbëdhjetë**

**Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për groposjen e kafshëve me sëmundje infektive, në fshatin Bërnicë e Epërme, në Prishtinë.**

**Mimoza Sylejmani**, drejtore e paraqiti arsyetimin për votimin e këtij propozim-vendimi.

**Kryesuesi konstatoi se më 24 vota për, u miratua Vendimi për caktimin e lokacionit për groposjen e kafshëve me sëmundje infektive, në fshatin Bërnicë e Epërme, në Prishtinë.**

---

**Faqe9nga10**

**Pika e shtatëmbëdhjetë**

**Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për Prishtina International Film Festival – Prifest.**

**Alban Zogaj**, nënkyetar, paraqiti arsyetimin në pika të shkurtra për përkrahje financiare të këtyre festivaleve.

**Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për, u miratua Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për Prishtina International Film Festival –Prifest.**

**Pika e tetëmbëdhjetë**

**Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për Shoqatën për kultivimin e artit skenik “Sythi”.**

**Kryesuesi konstatoi se më 16 vota për, 10 kundër, u miratua Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për Shoqatën për kultivimin e artit skenik “Sythi”.**

**Pika e nëntëmbëdhjetë**

**Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për festivalin Gran Fest – Kosova.**

**Kryesuesi konstatoi se më 14 vota për dhe 12 kundër, u miratua Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për festivalin Gran Fest – Kosova.**

*Mbledhja përfundoi në orën 15:00.*

**Procesmbajtësi  
Zijadin Gashi**



Faqe10nga10